



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.1, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15.1, 15 paragrafi 2.4 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 87.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, sipas Konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa nr.prot.01-016/01-0014172/22 të datës 25 shkurt 2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022, mori,

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2022

Neni 1

Miratohet Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022

Neni 2

Kuvendi i Komunës përveç pikave të parapara me këtë plan shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës, mban edhe mbledhje tjera varësisht nevojave dhe kërkesave të paraqitura për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Plani i punës, në formë tabelore, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot.01-401/05-0014592/22
Podujevë,
28 shkurt 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

PLANI I PUNËS **SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2022**

28 shkurt 2022

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Kuvendi i Komunës, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për.

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

-Si dhe akte tjera që parashihen dhe rregullohen me legjislacion tjetër, varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Komuna siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e akteve /dokumenteve të planifikimit hapësinorë, Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Hartës Zonale (HZK), dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH), plotësim ndryshimin/revidimin e tyre, si dokumenteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike dhe planifikohen etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera ligjore.

Me këtë plan, synohet arritja e objektivave për vitin 2022, ku Kuvendi i Komunës së Podujevës planifikon t'i mbaj të paktën 11 seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Podujevës, e të cilat janë të rregulluara me proceduara sipas legjislacionit në fuqi, ndër të tjera:

- Planifikon kohën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit dhe akteve tjera në fuqi;
- Funkcionalizimin e plotë të Komiteteve, komisioneve dhe trupave tjerë të Kuvendit, sipas ligjit, dhe planifikon raportimin e tyre para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Planifikon miratimin e buxhetit, planeve investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Planifikon miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës dhe akteve tjera ligjore;
- Planifikon shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve të reja dhe harmonizimin e rregulloreve ekzistuese konform ligjeve në fuqi;
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e Ekzekutivit të Komunës;

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2022 që kanë të bëjnë me interesat e Komunës dhe qytetarëve në përgjithësi.

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe eventualisht seanca të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne, siç parashihet me Ligj, Statutin e Komunës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit varësisht nevojave mban takime mujore me përfaqësuesit / shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, për të bashkërenditur punën e komiteteve obligative dhe funksionale dhe punën e Kuvendit të Komunës.

Për përmbushjen e planit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë plan, do të përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës i cili duhet që sa më shumë të jetë e mundur t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2022.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit/dokumentit - objektivin e tij, propozuesin e aktit si organ përgjegjës për përgatitjen të draftit të aktit, afatin e përparë të procedimit nga propozuesi, shqyrtimet nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022 sipas nevojave mund të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje dhe çështje të ngritura nga anëtarët e Kuvendit,
- Çështje tjera me rëndësi publike dhe në interes të qytetarëve dhe Komunës.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2022

JANAR 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	/////				
2.	/////				
3.	/////				
4.	/////				
5.	/////				

SHKURT 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	/////				
2.	/////				
3.	/////				
4.	/////				
5.	/////				

MARS 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtim i paraprak
1.	Raporti financiar për vitin 2021				
2.	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës				
3.	Informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Inspeksionit				
4.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë				
5.	Informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit				
6.	Miratimi i Hartës Zonale				
7.	Informatë e detajuar e punës së Prokurimit për vitin 2021				
8.	Bartjet Buxhetore nga viti 2021-2022				
9.	Draft rregullorja për tarifa dhe gjoba				
10.	Propozim, plotësim ndryshimi i rregullores së Teatrit				
11.	Të ndryshme				

PRILL 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraparak
1.	Raporti financiar tre mujor, Janar-Shkurt-Mars për vitin 2022				
2.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
3.	Informatë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik				
4.	Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural				
5.	Miratimi i rregullores së Drejtorisë së Arsimit				
6.	Miratimi i rregullores për Subvencione				
7.	Propozim për rregullore për palestër				
8.	Të ndryshme				

MAJ 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraparak
1.	Raporti i auditorit të brendshëm				
2.	Informatë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
3.	Informatë e Drejtorisë së Administratës				
4.	Miratimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba				
5.	Propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës				
6.	Të ndryshme				

QERSHOR 2022

Nr	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtim i paraparak
1.	Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2023-2025				
2.	Rishikimi i buxhetit për vitin 2022				
3.	Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021				
4.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale				
5.	Të ndryshme				

KORRIK 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar gjasht mujor Janar-Qershor 2022				
2.	Informatë e Drejtorisë së Arsimit 2021-2022				
3.	Informatë e Drejtorisë së Inspeksionit				
4.	Të ndryshme				

GUSHT 2022

Nr.	
1.	Pushim përveç ndonjë mbledhje për ndonjë çështje - rrethanë urgjente

SHTATOR 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Miratimi i projektbuxhetit për vitin 2023 dhe planifikimet buxhetore për vitet 2024-2025				
2.	Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022-2023				
3.	Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (me theks të veçantë korrje-shirjet)				
4.	Miratimi i normave tatimore të tatimit në pronë				
5.	Raporti i ndërmarrjeve publike				
6.	Të ndryshme				

TETOR 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar nëntë mujor periudha Janar-Shtator 2022				
2.	Ri-alokimi dhe transferi i buxhetit për vitin 2022				
3.	Informatë për gjendjen e Klubeve dhe statutin juridik të tyre, dhe pronave sportive				
4.	Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
5.	Miratimi i Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik Lokal				
6.	Të ndryshme				

NËNTOR 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Ngritja e grupit punues për hartimin e planit të punës për vitin 2023				
2.	Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale				
3.	Informatë e përgjithshme Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
4.	Raportim vjetor i përgjithshëm i Drejtorisë së Kulturës për Rini dhe Sport				
5.	Të ndryshme				

DHJETOR 2022

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023				
2.	Informatë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik				
3.	Të ndryshme				

Podujevë,
28 shkurt 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Nilmi Hoxha